



KOMITETI PËR KOMUNITETE

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 02/06/22

Datë: 23. 09. 2022, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen Gjashtë të Rregullt të Komitetit për Komunitete, mbajtur me datën 23 Shtator 2022, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Zejnepe Gaxherri - kryesuese, përfaqësuese (LDK),
2. Zenel Maloku - përfaqësues (AAK),
3. Eliza Pepshi - përfaqësuese (LVV),
4. Valdrin Isufaj - përfaqësues (Komuniteti i Biznesit), dhe
5. Safete Shehu - përfaqësuese (OJQ Qershiza).

Mbledhjen e Gjashtë të Rregullt të Komitetit për Komunitete e kryesoj znjsh. Zejnepe Gaxherri, ndërsa prezantoj dhe kërkoj miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit, dhe
2. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u shqyrtua dhe u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Parë e Rendit të Ditës

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit, i cili shqyrtua dhe u miratua nga të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Dytë e Rendit të Ditës Të ndryshme

Fjalën e kërkoj z. Zenel Maloku i cili tha, në Rendin e Ditës është dashtë të shtohen pika tjera, siç është çështja apo vlerësimi i grevës në Arsim, apo ndonjë çështje tjetër. Kjo sipas meje nuk është në rregull, sepse ne duhet t'i adresojmë kërkesat e qytetarëve, dhe pikërisht për këtë është formuar ky Komitet.

Kryesuesja znjsh. Zejnepe Gaxherri, tha të gjitha çështjet mund t'i diskutojmë edhe në pikën e Rendit të Ditës, *Të ndryshme*.

Me këtë nuk u pajtua z. Zenel Maloku, i cili tha, çështjet e caktuara duhet të jenë pika të veçanta të Rendit të Ditës.

Z. Zenel Maloku tha, tjetër, sipas Kryesuesit të Kuvendit ne si Komitet duhet t'i mbajmë vetëm dhjetë mbledhje të rregullta në vend të dymbëdhjetë mbledhjeve, dhe as kjo për mua nuk është në rregull, sepse çdoherë janë mbajtur dymbëdhjetë mbledhje të rregullta të Komitetit për Komunitete.

Kryesuesja znjsh. Zejnepe Gaxherri tha, kjo nuk është e përcaktuar në Rregullore. Aty ceket që mbledhjet të mbahen sipas nevojës.

Z. Zenel Maloku ngriti edhe çështjen e ndriçimit publik, dhe tha se ndriçimi publik nuk funksionon gati në gjysmën e Juniku, dhe as kjo sipas meje nuk është në rregull, dhe unë kërkoj sanimin e kësaj gjendjeje.

Znj. Safete Shehu foli për çështje e mbeturinave dhe ndërprerjen e kontratës për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave nga firma "VB-Tofaj". Ne kemi paguar për mbeturinat dhe tani është kontraktuar një firmë tjetër nga Peja. Kjo nuk është në rregull, dhe është mirë që ne së paku të informohemi nga Komuna lidhur me këtë çështje.

Çështja tjetër është edhe çështja e mësimi, pra grevës në Arsim, ku prindërit e nxënësve në Junik është dashtë që të organizohen dhe të filloj mësimi në Junik. Kjo është brengosese për mua shtoj, znj. Safete Shehu.

Znjsh. Eliza Pepshi tha, për mua është brengosese edhe çështja e qeneve endacak në Junik, që paraqet rrezik për fëmijët dhe qytetarët e Junikut. Komuna duhet të ndërmarrë masa për sanimin e kësaj çështje poashtu.

Lidhur me këtë, z. Zenel Maloku tha, është përmendur nga Ekzekutivi i Komunës që të ndërtohet një strehimore për qenet endacak, mirëpo kjo nuk po ndodhë, sepse kjo po duket të jetë vetëm fontanë dëshirash!

Ndërsa lidhur me çështjen e mbeturinave, se si Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit e kanë paraparë që t'i heqin nga puna katër punëtorë të Junikut, dhe t'i marrin ata nga Peja është e pakuptimtë, tmerr dhe punë e çoroditur.

Tjetër, unë çdoherë kam ngritur edhe çështjen e nxënies së trotuareve në Junik, mirëpo kjo asnjëherë nuk është marrë parasysh, dhe nuk janë ndërmarrë masa për këtë as nga qeverisja e kaluar, as nga kjo e tanishmja.

Çështje tjetër është kujdesi për personat e moshuar dhe personat e vetmuar në Komunën e Junikut, të cilëve është e nevojshme që t'u ndihmohet me dru për djegie për sezonin e Dimrit.

Znjsh. Zejnepe Gaxherri lidhur me këtë tha, ne nuk e kemi një listë dhe nuk e dimë se kush ka nevojë për këtë ndihmë, dhe se a do t'i pranonin ata qytetarë këto ndihma.

Tjetër. Z. Zenel Maloku i sugjeroj Kryesueses që ajo mund të thirrë mbledhje të jashtëzakonshme të Komiteti për Komunitet nëse këtë e kërkon nevoja, ndërsa tha, unë të gjitha këto çështje do t'i cekë në mbledhjen e Kuvendit.

Z. Valdrin Isufaj bëri apel që të gjendet një zgjidhje për fillimin e mësimin në Komunën e Junikut, për të cilën gjë u pajtuan të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Për fund, z. Zenel Maloku kërkoj informim me shkrim nga Komuna për takimet me qytetarë, pra kërkoj që qytetarët të njoftohen përmes ftesave fizike nëpër shtëpi, shtylla elektrike, lokale dhe vende të tjera te qasshme për informim.

Me kaq, kryesuesja znjsh. Zejnepe Gaxherri e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotshme të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtësi,

Gëzim Geci

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete,

Zejnepe Gaxherri